

## LETËNJOFTIMI I SHKOLLËS

*Sh.F.K. "Bratstvo – Migjeni" në Tetovë, është shkollë qendrore e qytetit e zhvilluare e cila ka një shkollë periferike në Saraqinë dhe dy objekte të dislokuara në Tetovë. Është një ndër më të vjetrat në komunën e Tetovës. Është themeluar në vitin 1958, ku mësimi është zhvilluar në gjuhën maqedone dhe shqipe nga klasa e parë në të tetën. Më vonë filloi mësimi në gjuhën turke prej klasës së parë deri në të katërtën. Në vitin 1993 shkolla ndërroi emrin në "Bratstvo – Migjeni". Sot në të nxënësit ndjekin mësimin në gjuhën shqipe nga klasa e I-IX në Tetovë (Qendër, Drenovec) dhe nga kl I-V në Saraqinë, në gjuhën maqedone nga klasa e I-IX në Tetovë (qendra sportive dhe Saraqinë), si dhe në gjuhën turke nga klasa e I-V Tetovë (objekti në Qendër).*

*Qëllimi i shkollës është t'ju mundësoj nxënësve zhvillim individual në pajtim me predizpozitat dhe tek to të zhvillohet ndjenja e përgjegjësisë, traditat kulturore dhe vetëdijësim për përkatësi në R.Maqedonisë së veriut si shtet multietnik, me aplikim të integritimit multietnik në arsim dhe në atë drejtim të respektojnë dhe përmbushin të drejtat dhe obligimet qytetare të tyre. Shkolla kujdest t'i aftësoj nxënësit të zbatojnë efektet pasuese të fituara nga arsimi në fusha të ndryshme të jetës .*

## QËLLIMET STRATEGJIKE TË SHKOLLËS DHE PRIORITETET

**PRIORITET:** 1. Ofrimi i mbështetjes për nxënësit që kanë nevojë për ndihmë për përparim më të suksesshëm në punën edukativo-arsimore dhe nxënësit me nevoja të veçanta

**PRIORITET:** 2. Ndërtimi i dy klasave dhe sallave sportive në SHFK.

**PRIORITET:** 3. Bashkëpunimi më i madh i shkollës me prindërit/tutorët

**PRIORITET:** 4. Bashkëpunimi ndërmjet nxënësve, arsimtarëve dhe personave të tjerë kompetentë për zgjidhjen e problemeve që i shqetësojnë nxënësit – pjesëmarrja në "Ditën e Hapur nga Arsimi Qytetar". " – aplikimi i arsimit multietnik në veprim.

**PRIORITET:** 5. Implementimi i suksesshëm i Konceptit të ri për arsimin fillor nga klasa e parë deri në të gjashtën.



## SHKOLLA FILLORE KOMUNALE „BRATSTVO-MIGJENI,, TETOVË



**Adresa :**  
**"Ljubo Bozhinovski – Pish" nr.41**  
**1200, Tetovë**  
**Tel : 044 336 920**  
**Faks: 044 336 920**

## ORGANET E DREJTUESE, UDHËHEQËSE DHE ORGANET PROFESIONALE TË SHKOLLËS

Bordi i shkollës
Drejtori
Ndihm. Drejtori / 2
shërbimi profesional ( pedagog, psikolog, defektolog, punonjësit social dhe 2 bibliotekist)
Këshilli i prindërve
Aktivitetet profesionale
Kujdestarët e klasave
Anëtarët e ekipit inkluziv
Bashkësia e klasës
Anëtarët e parlamentit të nxënësve
Fëmiu ombudsman

### TË PUNËSUAR

Në mësimin në gj.shqipe janë të kyqur 78 arsimtarë

Në mësimin në gj.maqedone janë të kyqur 56 arsimtarë

Në mësimin në gj. Turke , në grupin klasor janë të kyqur 7 arsimtarë

Në shkollë ka një drejtor , dy ndihmës drejtorë, një pedagog, një psikolog, një defektolog, një punonjësit social 2 bibliotekar, një sekretar, një kontabilist, dhe 17 të punësuar si personel teknik.

### MËSIMI

Lloji i mesimdheneies

- Mesim obligativ
- Mesim zgjedhor
- Mesim plotësues
- Mesim shtues
- Programe individuale
- Programe per Eko aktivitete
- Projekte te cilat realizohen ne shkollë
- Perdorimi I TIK-ut ne mesim

#### Mësimi plotësues

Sipas fondit të nevojshëm për këtë lloj të mësimdheneies tëorëvenë niveltë paraleles llogaritet fondivjetorpërçdo lëndëdhe për çdo arsimtar, i ciliprej 20.09. bëhe pjesë e orarit dhe programit vjetor. Për mësim plotësues formimi i grupeve do të bëhet në kohë të ndryshme varësisht prej kohës kur do të paraqiten dobësi të caktuara te nxënës te ndryshëm. Ky mësim do të organizohet përgjatë gjithë vitit mësimor, paralelisht me mësimin e rregullt, pas orëve mesimore, në kohën e lirë dhe si mësim vazhdues në fund të vitit shkollor.

#### Mësimi shtues

Sipas fondit të nevojshëm për këtë lloj të mësimdheneies tëorëvenë niveltë paraleles llogaritet fondivjetorpërçdo lëndëdhe për çdo arsimtar, i ciliprej 20.09.bëhe pjesë e orarit dhe programit vjetor. Mësimi shtues do të realizohet me nxënës të cilët arrijnë rezultate të vecanta ne Disiplina të caktuara shkencore dhe përparojnë nëkornizat e mësimit obligtaiv. Qëllimi i tij kryesor është që të sigurojë një punë sistematike me nxënës që kanë dhunti dhe talent gjatë gjithë vitit, angazhimin e tyre kreativ, përmirësimin e aftësive, orijntimin e ngushtë profesional, pjesëmarrja në gara etj.

## MISIONI DHE VIZIONI I SHKOLLËS

### Misioni

Implementimi i vlerave me të cilat arrihet një shkollë efektive në një mjedis multietnik.

### Vizioni

Shkolla jonë do të jetë një mjedis që ofron mbështetje zhvillimit individual të të gjithë nxënësve dhe zhvillimit profesional të arsimtarëve, gjë që çon deri në një proces cilësor edukativo-arsimor.

Numri I nxënësve në vitin skollor 2023/24

	Mësim në Gj.shqipe	Mësim në gj.Maqedone	Mësim në Gj.turke
Num.i parall.	33	50	4
Num.i nxënësve	625	1044	21